




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. l faq Broj stranica Nr. pages	02
Nr Prot Br Prot Prot No.	06-963/20
Data Datum Date	15-05-2020
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.05.2020, nxjerrë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2840/19, për zyrtarin e lartë publik z. Refki Piraj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për zyrtarin e lartë z. Refki Piraj, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011 Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare e ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit sipas të cilit z. Piraj, krahas ushtrimit të funksionit si Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, njëkohësisht ishte edhe përfaqësues i autorizuar në biznes privat.

Për t'i vërtetuar dyshimet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare me numër DPKI-06-2564/1 është konstatuar se z. Piraj mbante edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-2840/19, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga z. Piraj, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me të, me ç'rast është njoftuar për pajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik, konkretisht me atë se gjatë ushtrimit të funksionit si Gjyqtar, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksionin e përfaqësuesit të autorizuar në biznes privat, pasi që një gjë e tillë është e ndaluar me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.”

Zyrtari i lartë z. Piraj, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndërmarrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare *DPKI-06-902/20*, me të cilën dëshkohet se zyrtari i lartë ka ndërmarr veprimet e nevojshme, duke bërë shuarjen vullnetare të biznesit në të cilin ka qenë person i autorizuar.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Piraj, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip HAVOLLI
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

